

Doracak për prindin. Standardet e Shtetit "CommonCore"

KULTURA E GJUHËS ANGLEZE DHE MATEMATIKA

Në vitin 2010, Bordi i Regjentëve të Shtetit të New Yorkut miratoi Standardet e Shtetit "Common Core" (CCSS) me qëllim që të gjithë fëmijët të arrijnë suksese pas përfundimit të shkollës së mesme. Ky doracak është hartuar për t'ju ndihmuar që të kuptoni se si do të ndikojnë standardet te fëmija juaj, çfarë ndryshimesh do të vëreni si dhe se çfarë mund të bëni në shtëpi për të ndihmuar fëmijën tuaj me mësimet.

Përse janë të rëndësishëm Standardet e Shtetit "CommonCore"?

Standardet e Shtetit "CommonCore" janë të rëndësishëm sepse ata do të ndihmojnë të gjithë fëmijët – pavarësisht se cilët janë – që të mësojnë të njëjtat aftësi. Këto standarde japin ide të qarta lidhur me atë se çfarë duhet të dijë dhe të jetë i aftë të bëjë fëmija në lëndët kryesore **lexim shkrim, të folur, dëgjim, gjuhë dhe matematikë**. Nëse ju e dini se cilat janë pritshmëritë atëherë ju mund të punoni me mësuesin dhe të ndihmoni fëmijën tuaj të përgatitet.

KULTURA E GJUHËS ANGLEZE (ENGLISH LANGUAGE ARTS - ELA)

Standardet e reja të Shtetit "CommonCore" sjellin disa ndryshime të rëndësishme të standardeve aktuale, të cilat i quajmë ndryshime. Tabela e mëposhtme tregon se çfarë sjellin këto ndryshime, çfarë mund të shihni në çantën fëmijës si edhe çfarë mund të bëni për të ndihmuar fëmijën. Nëse detyrat e fëmijës nuk reflektojnë këto ndryshime, atëherë bisedoni me mësuesin e fëmijës.

Çfarë quajmë ndryshim?	Çfarë të kërkon në çantën e fëmijës?	Çfarë mund të bëni?
<ul style="list-style-type: none"> Fëmija do të lexojë në çdo klasë më shumë materiale jo letrare. 	<ul style="list-style-type: none"> Kujdesuni që fëmija juaj të ketë më shumë detyra leximi të bazuara në ngjarjet e jetës së përditshme si për shembull biografi, artikuj si dhe ngjarje historike. 	<ul style="list-style-type: none"> U lexoni fëmijëve librat që trajtojnë ngjarje reale. Gjeni mënyrat për ta bërë leximin sa më tërheqës dhe të pëlqyeshëm.
<ul style="list-style-type: none"> Leximi i më shumë teksteve reale letrare do të ndihmojë fëmijën që të mësojë rreth botës nëpërmjet leximit. 	<ul style="list-style-type: none"> Kujdesuni që fëmija juaj të sjellë në shtëpi më shumë libra të bazuar në fakte që lidhen me botën. Për shembull, fëmija juaj që është në klasën e parë ose në kopsht mund të lexojë librin e Clyde Robert Bulla "Pema është një bimë". Ky libër ndihmon nxënësit që të lexojnë për shkencën dhe ta kuptojnë atë. 	<ul style="list-style-type: none"> Mësoni cilët libra që trajtojnë ngjarjet reale janë të përshtatshëm për klasën e fëmijës suaj si dhe përpuni që fëmija të mund ti gjejë këto libra.
<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët do të lexojnë tekstet e vështirë me shumë kujdes në mënyrë që ata të kuptojnë atë që lexojnë dhe të nxjerrin vetë konkluzionet. 	<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët tuaj do të kenë detyra me shkrim dhe detyra leximi që mund tu kërkojë atyre të ritregojnë ose të shkruajnë rreth pjesëve kryesore të një tregimi ose libri. Për shembull, fëmijës në klasën e dytë ose të tretë mund ti kërkohet të lexojë me zë të lartë librin real letrar të Faith D'Aluisio të titulluar "Çfarë ha bota" si edhe të ritregojë faktet nga tregimi. 	<ul style="list-style-type: none"> U jepni fëmijëve të lexojnë më shumë tekste të vështira. Tregohuni ju atyre si të hyjnë më thellë në pjesët e vështira.
<ul style="list-style-type: none"> Kur është fjala për të shkruar ose treguar përmbajtjen e një tregimi, fëmijët do të përdorin "faktet" që kanë mbledhur nga tregimi për të mbështetur atë që thonë. 	<ul style="list-style-type: none"> Shikoni detyrat me shkrim që i kërkojnë fëmijës të japë shembuj konkretë të marrë nga teksti që shërbejnë si fakte. Fakt nënkupton shembujt e marrë nga libri që fëmija do të përdorë për të mbështetur një konkluzion ose një përgjigje. Kjo ndryshon nga pyetjet lidhur me mendimet rreth tekstit që janë përdorur në të kaluarën. 	<ul style="list-style-type: none"> I kërkon fëmijës të japë fakte gjatë diskutimeve dhe debateve të përditshme.
<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët do të mësojnë si të shkruajnë nëpërmjet leximit. 	<ul style="list-style-type: none"> Shikoni për detyrat me shkrim që i kërkojnë fëmijës të japë argumentet me shkrim në bazë të fakteve. Nxënësit e klasës së katërt dhe të pestë mund të lexojnë dhe shkruajnë rreth librit jo letrar "Udhëzuesi i fëmijëve për paratë" të autorit Steve Otfinoski. 	<ul style="list-style-type: none"> I nxisni të shkruajnë në shtëpi. Shkruani së bashku duke përdorur fakte dhe hollësi.
<ul style="list-style-type: none"> Fjalori akademik i fëmijës do të rritet. 	<ul style="list-style-type: none"> Shikoni për detyrat që zgjerojnë fjalorin e fëmijës dhe u meson atyre se "gjuha është forcë". 	<ul style="list-style-type: none"> Lexojuni shpesh bebeve, motakëve, parashkollorëve dhe fëmijëve.

MATEMATIKA

Për të përmirësuar mënyrën e të mësuarit të nxënësve, Standardet e reja të Shtetit "Common Core" janë të ndryshme nga standardet e mëparshme, prandaj i quajmë ndryshime. Tabela e mëposhtme tregon se çfarë sjellin këto ndryshime, çfarë mund të gjeni në çantën e fëmijës si edhe se çfarë ju mund të bëni për të ndihmuar fëmijën. E përsërisim, nëse detyrat e fëmijës nuk pasqyrojnë këto ndryshime, atëherë bisedoni me mësuesin e fëmijës.

Çfarë quajmë ndryshim?	Çfarë të kërkon në çantën e fëmijës?	Çfarë mund të bëni?
<ul style="list-style-type: none"> Fëmija juaj do të hyjë më thellë në më pak tema, gjë që do ta ndihmojë të kuptojë plotësisht (më pak nënkupton më shumë!). 	<ul style="list-style-type: none"> Shikoni për detyrat që u kërkojnë nxënësve të tregojnë punën e tyre si edhe të shpjegojnë pse dhanë atë përgjigje. 	<ul style="list-style-type: none"> Njihuni me konceptet që janë të rëndësishme për fëmijët tuaj në bazë të klasës si dhe lini kohë për të punuar me këto koncepte.
<ul style="list-style-type: none"> Fëmija juaj do të vazhdojë të ndërtojë njohuritë vit pas viti, mbi një themel të fortë. 	<ul style="list-style-type: none"> Shikoni për detyrat që forcojnë njëra tjetrën. Për shembull, nxënësit do të përqendrohen në veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit. Sapo të përvetësohen këto veprime fëmijët do të përqendrohen në thyesat. Pas përvetësimit të tyre ata do të përqendrohen në algjebër. Ju do të shihni ecurinë e tyre në lëndët që mësojnë. 	<ul style="list-style-type: none"> Njihuni me konceptet për të cilët fëmija juaj ka pasur vështirësi vitin e mëparshëm dhe ndihmoheni në fushat e vështira për të.
<ul style="list-style-type: none"> Fëmijës do t'i duhet kohë të praktikojë dhe mbajë mend veprimet matematikore. 	<ul style="list-style-type: none"> Shikoni për detyrat që i kërkojnë fëmijës të përvetësojë veprimet matematikore si për shembull grupimin e mbledhjes deri në 20 si edhe tabelat e shumëzimit. 	<ul style="list-style-type: none"> Ndihmoni fëmijën të mësojë dhe mbajë mend veprimet matematikore bazë. I kërkonti fëmijës të "bëjë veprimet matematikore" që shfaqen në jetën e përditshme.
<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët do të kuptojnë se përse matematika funksionon si edhe do t'ju kërkohet të flasin rreth saj dhe si e kuptojnë atë. 	<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët mund të kenë detyra që u kërkojnë të tregojnë ose shpjegojnë mënyrën e të menduarit për veprimet matematikore - të tregojnë se përse mendojnë se përgjigja e tyre është e saktë. 	<ul style="list-style-type: none"> Bisedoni me fëmijët rreth detyrave matematikore dhe u kërkonti atyre që t'ju mësojnë koncepte të reja. I ndihmoni që të gjejnë mënyrat për të shpjeguar të menduarit e tyre.
<ul style="list-style-type: none"> Fëmijës do t'i kërkohet tani të përdorë matematikën në situatat e botës reale. 	<ul style="list-style-type: none"> Shikoni për detyrat e matematikës që bazohen në botën reale. Për shembull, detyra e shtëpisë për klasën e pestë mund të përfshijë mbledhjen e thyesave si pjesë e një recete ëmbëlsirash ose bazuar në thyesat, të gjendet sa pica hëngrën shokët. 	<ul style="list-style-type: none"> Çdo ditë gjeni kohën që fëmija juaj të punojë me matematikën në shtëpi.

BISEDA ME MËSUESIN E FËMIJËS

Kur të bisedoni me mësuesin e fëmijës, mundohuni që biseda të përqendrohet në çështjet më të rëndësishme që lidhen me fëmijën. Kjo nënkupton pyetjet drejtuar mësuesit lidhur me ecurinë e fëmijës tuaj bazuar në standardet dhe pritshmëritë e nivelit të klasës së tij.

Po ashtu, kërkonti që t'ju jepet një mostër e detyrave së fëmijës. Krahasoni mostrat e fëmijës tuaj me ato që gjenden në faqen e internetit <http://www.engageny.org/resource/new-york-state-common-core-sample-questions> Po ashtu, mos hezitoni që të sillni mostrat e detyrës së fëmijës tuaj tek mësuesi dhe të pyesni mësuesin se si këto detyra përdoren në klasë.

Ky informacion do t'ju ndihmojë që të bëni ndryshimet e rëndësishme në shtëpi që të ndihmoni fëmijën që të arrijë sukses në klasë.

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen në internet www.engageny.org ose të kontaktoni drejtorin lokal ose drejtorin e drejtorisë arsimore.